

V E N D I M
Nr. 299, datë 27.6.2002

PËR RITJEN E PAGAVE TË GJYQTARËVE DHE TË PROKURORËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7800 datë 2.3.1994 "Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve rriten në masën 12 për qind sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002.

3. Vendimi nr.425, datë 11.6.2001 i Këshillit të Ministrave "Për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

PASQYRA NR.1
PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PROKURORIVE

Në prokuroritë e apelit	
1. Prokuror apeli	83 400 lekë
2. Zëvendësprokuror apeli	69 950 lekë
3. Prokuror	65 850 lekë

Në Prokurorinë e Rrethit Tiranë	
1. Prokuror rrethi	65 850 lekë
2. Zëvendësprokuror rrethi	58 180 lekë
3. Prokuror	53 790 lekë

Në prokuroritë e rretheve	
1. Prokuror rrethi	58 180 lekë
2. Zëvendësprokuror rrethi	53 790 lekë
3. Prokuror	50 490 lekë

PASQYRA NR.2
PAGA MUJORE E GJYQTARËVE

Në gjykatën e apelit civil dhe në gjykatën ushtarake të apelit	
1. Kryetar	83 400 lekë
2. Zëvendëskryetar	69 950 lekë
3. Gjyqtar	65 850 lekë

Në gjykatën e Rrethit Tiranë	
1. Kryetar	65 850 lekë
2. Zëvendëskryetar	58 180 lekë
3. Gjyqtar	53 790

Në gjykatat e rretheve	
1. Kryetar	58 180 lekë
2. Zëvendëskryetar	53 790 lekë
3. Gjyqtar	50 490 lekë

PASQYRA NR.3
PAGAT E INSPEKTORATIT PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

3.1. Kryeinspektorë dhe inspektorë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë

1. Kryeinspektor 83 400 lekë
2. Zëvendëskryeinspektor 69 950 lekë
3. Inspektor 65 850 lekë